Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**27.06.2023**	**10.07.2023**	**2023/0401**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.06.2023, OE "HARST Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0401, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "HARST Group SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i palestres ne Zahaq RITENDER" me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0401 i dt:16.06.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së- Qëllimi

Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Përshendetje të nderuar,

Paraprakisht ju njoftojmë që në Vendimin e parë për Rekomandim për kontratë , AK neve si GOE na ka vlerësuar si të përgjegjshëm mirëpo OE i rekomanduar për kontrat e ka fituar tenderin me poentim, dhe pas Kërkesës tonë për Rishqyrtim ku kemi cekuar që poentimi është bërë gabimisht dhe kemi cekur që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm , AK ka lëshuar një Vendim të dytë për rekomandim për kontrat për OE e njëjt, dhe ka pranuar që ka gabim në poentim, mirëpo për të mbajt OE e njejt fitues AK ka pontecuar disa pika kinse ne nuk i kemi plotësuar sipas DT, që supozojmë që janë plotësisht të paqëndrueshme dhe kanë për qëlllim vetëm dëmtimin, pabarazin, diskriminimin tonë dhe favorizimin e OE të rekomanduar.

Në kërkesën e dytë për rishqyrtim AK i ka refuzuar gjitha pretendimet tona si të pa bazuara.

Në vazhdim gjeni pretendimet e AK dhe pretendimet tona dhe sqarimet:

Pretendimi 1 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. lidhur me arsyen e pabazuar të eliminimit 1:

Eliminimi 1 nga AK citoj: Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm për këtë arsyje:

Nuk është plotësuar si duhet Aneksi – 7 AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE.

Sipas, kërkesës 9 plani dinamik, ju keni ofruar planin dinamik 150 ditë punë.''

Kjo arsye eliminuese është e pa bazuar dhe e paqëndrueshëm për arsye që mbrenda planit dinamik janë të cekura të gjitha ditë që do të punohen dhe gjdo ditë e punës është ditë punë, sepse nuk mund të emërtohet në gjuhen shqipe ndryshe. Kjo arsye është edhe e pabazuar ku supozojm që për të bërë kinse është plani dinamik gabim, supozojm që AK ka manipuluar me foton, pasi që ka paraqit vetëm një pjesë të planit dinamik që i është përshtat. Plani dinamik i prezentuar nga ana e jonë është i punuar mjaft profesionalisht

dhe është plan dinamik i parapara për secilen ditë dhe ka afat prej 150 ditë nga data e fillimit të punimeve që në gjuhen shqipe janë 150 ditë pune mbrenda afatit të caktuara prej 150 ditë kalendarike. Kjo arsye eliminuese është e pabazuar për arsye që ne edhe në sistem e kemi plotsuar 150 ditë ashtu siq ka qenë kërkesa në DT. Andaj bazuar në ato që cekum dhe planin dinamik të dorzuar nga ana e jonë, supozojm që arsyeja e eliminimit nuk qëndron, mirpo është arsye në pamundësi për kalimin me poentim të konzerciumit tonë.

Pretendimi 2 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. lidhur me arsyen e pabazuar të eliminimit

Eliminimi 2 nga AK citoj: Ne Dosien e Tenderit nga A.K te kerkesa 6 eshte kerkuar „Operatori duhet të deshmoj se sistemi menaxhues i ofertuesit permbush kriteret e percaktuara ne fushen e ndertimtaris se pako per keto ISO standard

ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimin Mjedisor

ISO 3834 – 2 2006 -ISO

ISO 45001 2015 - Certifikata për menaxhimin e shëndetit në punë EN

Dëshmia 6 Operatori Ekonomik duhet të jetë i paijisur me Certifikatat ISO valide (kopje)

Vrejtje Kopja e Certifikates Iso apo ciles do Certifikate me te avancuar se kjo.

Me rregulloren e re "Rregullore Nr. 001/2022 për prokurimin publik" Neni 26 - Grup i Operatorëve Ekonomik, ceket:

26.6 Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.

Pra secili antar, duhet të ketë çertifikatat e kërkuara. Pas analizimit të dokumentacioni tuaj,

konstatojmë se ju keni dorëzuar ISO 3834 – 2 2005, që është version më I vjetër sesa ISO 3834 – 2 2006 e kërkuar në DT. Në dosjen e tenderit është cekur, se pranohen ISO më të avancuara, dhe jo ISO më të vjetra.

Kjo, është definuar edhe me vendimin e OSHP 45/23, po në Komunën e Pejës.

Pra, antari i grupit "Harst Group" nuk ka prezentuar ISO 3834 – 2006, por një version më të vjetër, që është në kundërshtim me dëshminë Vrejtje Kopja e Certifikates Iso apo ciles do Certifikate me te avancuar se kjo.

Këto dy pika, janë pikat kyçe që përcaktojnë rrjedhjën e vendim-marrjës përfundimtare, duke shpallur të papërgjegjshëm GeO HARST Group SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K.; NIVA

Kjo arsye eliminuese supozojm që është e paqëndrueshme për arsye që Iso standartet kan qenë tek Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale e jo tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale që do të duhej të gjithë antarët e grupit ti plotësonin, nërsa në rastin tonë edhe pse nuk ka qenë kërkes të plotësohen nga të gjithë antarët, ne kemi rastin ku të gjithë partnerët janë të standartizuar me ISO standartet e kërkuara. Kjo arsye eliminuese supozojm që është plotësisht e pabazuar pasi që partnerët Construmax dhe Niva Construction janë të certifikuar me ISO 3834-2-2006, ndërsa lideri Harst Group e ka të prezentuar ISO 3834-2-2005 të gjitha janë valide. Edhe nëse njëri nga partnerët nuk do të dorëzonte ISO-të përsëri nuk do të duhej eliminuar pasi që kjo kërkesë është tek ,,Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale'' ku në këto kërkesa përfshihen edhe stafi inxhinierike, referencat,teknikët, paisjet etj. , të cilat duhet plotsuar si grup e jo secili antar, pasi që ne p.sh siq jemi 3 antar do të duhej secilen kërkes të trefishojm. Kjo arsye eliminuese është e pabazuar edhe për faktin që nëse AK ka vlersuar që ISO duhet plotsuar të gjithë antarët, bie në kundërshtim me vetë vlersimin e juaj që keni vlersuar për kërkesat tjera të plotsoj vetëm njëri antar në emër të grupit konform ,,Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale''. Gjithashtu kjo arsye eliminuese është e pabazuar edhe për faktin që ISO 3834-2-2005 është e njejta me ISO 3834-2-2006 ku gjeni edhe sqarimin e trupes qertifikuese.

Pretendimi 3 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction

sh.p.k. lidhur me arsyen e pabazuar të eliminimit

Eliminimi 3 nga AK citoj:

Ne Dosien e Tenderit nga A.K te kerkesa e stafit

2.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike) me minimum 5 vite

përvojë pas diplomimit. I certifikuar per efiçience te energjise.

2.3 .Diploma (e noterizuar) dhe çertifikata për efiçiencë të energjisë nga institucioni I

akredituar (e noterizuara), dhe Cv e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të

noterizuara (OE dhe nga inxhinineri).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit tuaj, konstatojmë së për këtë pozitë keni paraqitur dy

inxhiniera, por të cilët nuk plotësojnë kushtin e DT 2.3

1. Sahit Bajram - mungon çertifikata për efiçiencë të energjisë

2. Skender Nitaj – është I diplomuar në drejtimin Elektronikë, ndërsa në DT është kërkuar

drejtimi energjetike.

Kjo është në kundërshtim me:

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në

fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe

në dosjen e tenderit.

Pra, si përfundim inxhinieri I elektros nuk përmbush të gjitha kërkesat e DT.

Kjo arsye eliminuese supozojm që nuk qëndron për arsye që ne kemi prezantu një listë të

stafit profesional ashtu siq cekur edhe kemi prezentuar dy ixhinier të elektros: Ne si GOE

kemi prezantuar dy inxhinier të Elektroteknikës që janë të certifikuar për efiqiencë.

Z. Sahit Hasani i cili është inxhinier i diplomuar elektroteknikës drejtimi energjetikë- i

certifikuar në efiqienc.

Dhe Z. Skender Nitaj i cili është inxhinier i diplomuar i elektroteknikes drejtimi

Elektronikë auditor i efiqiencës. Duke pasur parasysh që kërkesa 2.3 ka qenë 2.3 Një

Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike), ku bazuar në gjuhën shqipe

fjalët në kllapa kanë kuptimin ,,ose'', AK me eliminimin tonë për këtë arsye supozojm që

ka manipuluar me vetë shkrimin e kërkesës së tyre, ku ne kemi dorzuar të gjithë

dokumentacioni për ixhinierin e elektrotekinës z. Skender Nikaj duke përfshi edhe

qertifikaten e efiqiencës. Kjo arsye eliminuese nuk qëndron edhe për faktin që ne në

prezantimin e stafit për z. Sahit Hasani që është inxhinier i diplomuar i elektroteknik drejtimi energjetik, kemi cekur që është i trajnuar për efiqienc, dhe në rast që AK ka

mundur të gaboj në përshkrimin e kërkesës dhe ka menduar që rëndësia e madhe e këtij

projektit do të duhej që patjetër të jetë edhe inxhinier i elektroteknikës-drejtimi energjetik

, duhet të ketë trajnim në efiqienc apo certifikat të efiqiencës, AK do të duhej konform

nenit 72 të LPP-së dhe RrUOPP neni 38 të kërkoj sqarime për inxhinierin tjetër të cilën e

kemi të evidentuar në listën e stafit si inxhinier i elektroteknikës-drejtimi energjetik me

efiqiencë, ku mund të dorzohen të gjitha dokumentacionet të cilat ekzistenca e tyre është e

dëshmuarpara skadencës së afatit të dorzimit të ofertave citoj:

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket

të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të

kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë

informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e

tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat

dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet

ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të

verifikohet në mënyrë objektive.

Bazuar në sqarimet e dhëna, arsyeja eliminuese nr 3 është plotësisht e pa bazuar, në

kundërshtim me vetë kërkesën në DT pasi që këtë kërkes e plotson vetëm z.Skender Nitaj

–Inxhinier i elektroteknikës dhë në kundërshtim të plotë me neni 72 të LPP-së dhe

RrUOPP neni 38, pasi AK nuk ka kërkuar sqarime për inxhinierin tjetër të cilin e kemi

prezantuar.

Pretendimi 4 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. lidhur me arsyen e pabazuar të eliminimit

Eliminimi 4 nga AK citoj:

Ne Dosien e Tenderit nga A.K te kerkesa e listes se paisjeve

Kërkesa 7 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 3). Eskavator (Skip) – min. 1 cope

Dëshmia 7 Lista e pajisjeve dhe mekanizimit te OE ,te vulosura dhe te nenshkruara te deshmuar me libreza,per paisjet qe nuk regjistrohen te deshmohen me dud doganor të noterizuar ose fature. Për autokorpa OE duhet te ofroje raportet teknike te inspektimit (e noterizuara) nga nje kompani e licencuar per inspektim (te prezentohet licenca per inspektimit). Paisjet duhet të jenë në emër të kompanisë ose marrëveshje për marrje me qira e noterizuar.

Për pikën 3). Eskavator (Skip) – min. 1 copë keni paraqitur një dëshmi, marrëveshje, me OE "LG Construction Group SH.P.K", për paisjen Ngarkues me lugë, Marka: Fermec. Mirëpo kjo paisje nuk është në listën e asnjërit nga OE.

Kjo është ekuvalente me (Bazuar ne UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK)

Pra, Lista e paisjeve nuk përmbush kërkesat minimale të DT. Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Kjo arsye eliminuese nuk është e bazuar për faktin që ne kemi dorëzuar listën e makinerisë që kemi marrëveshje për shfrytëzim me Seti Commerc ku janë të evidentuara disa eskavator në këtë listë dhe kemi bashkangjitur edhe dëshmit lidhur me paisjet. Po ashtu në rast që kjo arsye eliminuese është kinse njëri nga eskavatorët që në këtë rast është potencuar për ngarkuesit me lugë dhe lugë mihëse i përdorur të marrveshjes për shfrytzim të LG construction Group nuk mund të kuptojm pse do të duhej të jetë patjetër kjo në listen e makineris, ku kemi disa eskvator në listë të makineris, apo ndoshta AK ka dashur të potencoj që për fjalën e cila gjendet në kllapa „skip'' e cila në gjuhen shqipe fjala skip

ska asnjë kuptim, po ashtu edhe në gjuhen shqipe fjalët në kllapa nënkuptojn „ose'' që në këtë rast është eskavator ose skip. Gjithashtu kjo arsye eliminuese është e pabazuar pasi që nga qasja në dokumentacion të OE të rekomanduar për kontrat dhe duke dashur të bëjmë krahasimin e paisjes së këtij OE dhe neve, ne nuk mundem të gjejmë ndonjë paisje makinerike në duda me emrin skip përpos eskvator, traktor. AK për eliminimin e kompanis tonë për këtë paisje është thirrur në Udhëzues Nr.001/2023, ku nuk ka të bëjë fare me paisje, dhe lexohet shumë qartë që është lista për kontrata të realizuar. Kjo arsye eliminuese forcon pretendimin tonë që edhe arsyeja nr 3 është e pabazuar pasi që eliminimi për arsyen 3 është bërë kinse nuk është parë evidentimi në listen e stafit që inxhinieri është i trjanuar në efiqiencë, e tash në arsyen eliminuese 4 AK ka vërejt që nuk është në listën e makineris (supozojm në dyshime lidhur me vlerësimin e komisionit me paanshëmri dhe konform deklaratës nën betim të tyre). Kjo arsye eliminues është në kundërshtim me nenin 72 LPP, RrUOPP dhe Udhëzimin që Nr. 001/2023, pasi që askund në LPP-në, e as në RrUOPP e as në Udhëzim nuk ceket që duhet të refuzohet një tenderues që nuk ka evidentuar në listen e makineris një nga paisjet e prezentuar të cilat kan mundur të mos jenë të kërkuara. Gjithashtu kjo është në kundërshtim edhe me LPP-në pasi që vetë AK ka deklaru që ne e kemi paisjen eskavator(skip) me të gjithë dokumentacionin, dhe na ka eliminuar që nuk ka qenë e evidentuar në listë. Ne supozojm që kjo është në kundërshtim edhe me nenin 1 qëllimin e LPP-së dhe neni 7 të LPP-së, pasi që të gjithë OE duhet plotsuar kriteret minimale për kryerjen e punimeve, ku në këtë rast ne kemi eskavatorin (skipin) e kërkuar në dosje të tenderit.

Pretendimi 5 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. - Konzerciumi i jonë bazuar në poentim është me pikë shumë më lartë se OE i rekomanduar për kontrat i cili supozojm që është edhe i papërgjegjshëm

Konzerciumi i jonë supozojm që kemi 100 pikë, pasi që konsiderojm që OE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm, mirpo edhe nësë do të konsiderohej i përgjegjshëm, ne si konzercium përsëri e kalojm me pikë këtë OE, si më poshtë

Pasi oferta parë është eliminiuar qmimi më i ulët është Ps=855,253.90 Euro

Garancioni me i gjate Ds=6 vite

Tenderi me planin me te shkurter te perfundimit Gt=150 dite

Bazuar ne qmimin e ofertuar, garancionin e ofertuar dhe planin dinamik te ofertuar, dhe duke kalkuluar ne metoden e vlersimit (formulimat e DT) rezulton qe ne si GOE do te duhej vlersuar me 99.96 pike, siq eshte evidentuar me poshte:

GOE HARST Group SH.P.K.&CONSTRUMAX SH.P.K.&NIVA Construction SH.P.K.

Pikët për tenderin: P=Ps/Pt*100=855,253.90/855,855.00*100=99.93*0.5=49.96

Piket për grancionin D=6/6*100=100*0.2=20

Pikët për aftain G=Gt/Gs*100=150/150*100=100*0.3=30

TOTALI=49.96 20 30=99.96 pikë

Pretendimi 6 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. lidhur me pretendimin që OE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm për arsye që bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të gjithë stafi inxhinierike dhe teknikët tek Dëshmia dokumentarë është kërkuar që Kontrata punë me qenë valide dhe e noterizuar, ku OE I rekomandaur për kontrat nuk ka dëshmuar për Inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë z. Blond Mecinaj nuk ka ofruar kontrat pune valide të noterizuar mirpo ka prezentuar një kopje të noterizuar, njejt si për stafin inxhinerët tjerë të cilët kanë kontrata të noterizuar. Bazuar në Kërkesën 2.1 e „Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale'', konsiderojm që OE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm pasi nuk plotson piken 2.1 2.1.Një inxhinier i diplomuar I ndërtimatrisë (drejtimi Konstruktiv) me 2 vite pervoje pune pas diplomit, i trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri dhe nderhyrjes ndaj emergjencave. I certifikuar per efiçience te energjise. Të jetë menaxher I projektit.

Në pikën 2.1 është kërkuar si në vazhdim

2.1.Një inxhinier i diplomuar I

ndërtimatrisë (drejtimi Konstruktiv) me 2

vite pervoje pune pas diplomit, i trajnuar

për mbrojtje dhe siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri dhe nderhyrjes ndaj emergjencave. I certifikuar per efiçience te energjise. Të jetë menaxher I projektit.

2.1 .Diploma (e noterizuar) dhe çertifikatat për efiçiencë të energjisë nga institucioni I akredituar (e noterizuara), çertifikata për mbrojtje dhe siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri (të noterizuara), çertifikata e nderhyrjes ndaj emergjencave (noterizuar) dhe Cv e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara, ose para kontrat ne emer te projektit të noterizuara Vendimi për menaxher të projektit I noterizuar, nënshkruar dhe vulosur nga të dy palët (OE dhe nga inxhinineri).

Pretendimi 7 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. lidhur me pretendimin që OE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm për arsye që bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka prezentu çertifikata të noterizuara nga kopja dhe jo nga dokument origjinal, dhe si të tilla mund të konsiderojm si çertifikata me dyshime mbi autenticitetin e tyre.

OE për pozitën suvatues ka prezantuar certifikatë të noterizuar nga kopja dhe jo sipas kërkesë në FDT-it , poashtu njëjtë edhe për pozitën pllaka shtrues.

Kërkesa 3

- Një (1) suvatues;
- Një (1) shtrues pllakash;

Dëshmia 3

Të dëshmohen me çertifikata (të noterizuara). I gjithe stafi të ketë çertifikata për mbrojtje dhe siguri në punë (te noterizuara) si dhe me kontrata pune aktive të noterizuar ose marrveshje për bashkpunim e noterizuar. Sepaku tre prej tyre te jene te çertifikuar per mbrojtje nga zjarri (e noterizuar).

Të prezentohet edhe licenca (e noterizuar) e kompanisë nga MPMS që ka kryer këto trajnime për siguri dhe shendet ne pune si dhe mbrojtje nga zjarri.

Pretendimi 8 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. lidhur me pretendimin që OE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm për arsye që bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pasi që z. Zeqir Mjeku nuk ka prezentu asnjë çertifikat apo dëshmi lidhur me trajnimin për ngjyrosje dhe mungojn dëshmit lidhur me përvojen e kërkuara 3 vjeqare, si dhe kopja e noterizuar është nga një dokument kopje e jo nga dokument origjinal dhe si e tillë mund të konsiderojm si çertifikata me dyshime mbi autenticitetin e tyre.

Kerkesa 4

Një (1) punetore i kualifikuar per sisteme me pllaka gipsi dhe ngjyrosje me 3 vitë përvojë pune

Deshmia 4

Diploma të noterizuar ose çertifikata të noterizuar, nga një qendër e aftësimit profesional ose trajnime si dhe me kontrata pune aktive të noterizuar ose marrveshje

për bashkpunim e noterizuar

Pretendimi 9 nga GOE Harst Group sh.p.k. & Construmax shpk & Niva Construction sh.p.k. lidhur me pretendimin që OE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm për arsye që bazuar në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te kërkesa 3 nuk e ka sipas kërkesës në DT, mirpo ka paraqitur një teknik i cili nuk përmbush kërkesën e DT, pasi që për këtë pikë OE i rekomanduar për kontrat ka prezantuar teknikin e elektros Z.Bekim Hajdari por për të cilin si certifikatë për efiqiencë ka prezantuar një certifikatë të lëshuar nga programi SEEK the trajnim të mbajtur nga GFA consulting group.

Ne vazhdim po jua elaborojmë rolin e kësaj qertifikate dhe njohurit që i kemi për këtë program. Me këtë certifikatë janë pajisur të gjithë nënkontraktorët që kanë kryer punë ekzekutimi për programin e efiqiencës dhe si kusht paraprak ka qenë që OE dhe stafi i tyre të pajisen me këtë certifikate në mënyrë që të fitojnë njohuri në përdorimin e programit të këtij fondi, program që është punuar për menagjimin dhe ngarkimin e situacioneve, faturave , raporteve , ofertave etj.

Pra ky trjanimi eshte mbajtur vetem per aftesimin e individav te kompanive për përdorimin e ketij sitemi GMAS i cili është i ngjajshëm me sistemin e e-prokurimit të kosovës dhe nuk do të thot se qdo person që e përdor e-prokurimin e kosovës është i certifikuar si zyrtar i prokurimit. Andaj konsiderojm që OE i rekomanduar është i papërgjegshëm në këtë pikë pasi që nuk ka prezantuar teknikin e Elektros me certificatë te efiqiencës. Më posht gjeni edhe dëshmit dhe diplomen e përkthyer komplet, pas që ju keni dërguar vetëm një pjesë të sajë në përgjigjëjen e kërkesës për rishqyrtim të parë.

Kërkesa 3

- Një (1) teknik I elektros i çertfikuar programin e efiçiences te energjise Të dëshmohen me çertifikata (të noterizuara). I gjithe stafi të ketë çertifikata për mbrojtje dhe siguri në punë (te noterizuara) si dhe me kontrata

pune aktive të noterizuar ose marrveshje
për bashkpunim e noterizuar. Sepaku tre
prej tyre te jene te çertifikuar per mbrojtje
nga zjarri (e noterizuar).
Të prezentohet edhe licenca (e noterizuar) e
kompanisë nga MPMS që ka kryer këto
trajnime për siguri dhe shendet ne pune si
dhe mbrojtje nga zjarri.

Bazuar në sqarimet e dhëna në lidhje me eliminimin e konserciumit tonë, me arsyetime aspak të bazuar dhe aspak të qëndrueshme, lehtë mund të konsiderojmë që të gjitha këto arsye eliminimit të cekura për konserciumin tonë janë me të vetmin qëllim për të na eliminuar kinse të papërgjegjshëm në pamundësi për kalimin e konserciumit tonë pasi kemi pasur pikë maksimale.Andaj supozojmë që për të arritur qëllimin AK për të rekomanduar këtë OE si fitues e vetmja mundësi ka qenë për të na eliminuar neve nga gara dhe e cila është plotësisht e pabazuar.

Bazuar në ato që cekum dhe sqaruam, supozojm që AK ka marrë vendim për rekomandim për kontrat një OE te pa përgjegjshëm me pikë më të ulëta se konzerciumi i jone në kundërshtim me LPP-në, duke na diskriminuar neve si OE me të vetmin qëllim që ne si OE të mos rekomandohemi per kontrat.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoritet kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më

transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe

të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu autoritet kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 59 të

LPP-së, pasi nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tendereve në

mënyrë të drejtë, në mënyr të njejtë dhe në mënyr të barabart.

Gjithashtu autoritet kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 60 të

LPP-së, pasi qe nuk na karekomanduar për kontrate neve si GOE të përgjegjshëm me pikë

maksimale, pasi qe kriteret e vendosura nga ana AK, rezultojn që ne jemi GOE i

përgjegjshëm me qmim më të ulët dhe me pikë maksimale.

duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja

që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE "Harst Group sh.p.k. & Construmax sh.p.k.& Niva

Construction Sh.p.k.. si e bazuar

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet

në

RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe

krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për

kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën

ligjore në institucionet tjera kompetente, për të gjitha shkeljet ligjore që supozojm kan

ndodhur në këtë procedur tenderuese.

KRITERET PËR VLERËSIM

	5.2	Afatet kohore për fillimindhe/osepërfundiminekontratës:**minimim 150 dit deri ne max 250 dit kalendarike.**	
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**apaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për renovim ose ndertim të objekteve të kategorisë -ndërtim i lartë në vler prej 1.200.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e shkuara.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të punëve**
		Kërkesa 2 **Staf Profesional i kualifikuar** **2.1. Një inxhinier i diplomuar I ndërtimatrisë (drejtimi Konstruktiv) me 2 vite pervoje pune pas diplomit, i trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri dhe nderhyrjes ndaj emergjencave. I certifikuar per efiçience te energjise. Të jetë menaxher I projektit.** **2.2 Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i çertifikuar për sistem të menaxhimit dhe shëndetit në pune.** **2.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike) me minimum 5 vite**	**Deshmia 2** **2.1 .Diploma (e noterizuar) dhe çertifikatat për efiçiencë të energjisë nga institucioni I akredituar (e noterizuara), çertifikata për mbrojtje dhe siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri (të noterizuara), çertifikata e nderhyrjes ndaj emergjencave (noterizuar) dhe Cv e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara, ose para kontrat ne emer te projektit të noterizuara Vendimi për menaxher të projektit I noterizuar, nënshkruar dhe vulosur nga të dy palët (OE dhe nga inxhinineri).** **2.2 .Diploma (e noterizuar), I**

			përvojë pas diplomimit. I certifikuar per efiçience te energjise. **2.4 Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë drejtimi hidroteknike me minimum 5 vite pervoje pune pas diplomimit, të jetë i qertifikuar ne AME per mbrojtje nga zjarri dhe te kete trajnim për shendete dhe siguri ne pune.** **2.5 Nje inxhinier i diplomuar i makinerise me minimum 5 vite pervoje pune pas diplomimit– drejtimi termoenergjetike dhe termoteknike.** **2.6 Nje inxhinieri i ndertimtarise me minim 5 vite pervoje pune pas diplomimit – drejtimi konstruktiv – te jete udheheqes I punishtes**	**çertifikuar për sistem të menaxhimit dhe shëndetit në pune (Te noterizuara), dhe Cv e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara, ose para kontrat ne emer te projektit të noterizuara (OE dhe nga inxhinineri).** **2.3 .Diploma (e noterizuar) dhe çertifikata për efiçiencë të energjisë nga institucioni I akredituar (e noterizuara), dhe Cv e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara, ose para kontrat ne emer te projektit të noterizuara (OE dhe nga inxhinineri).** **2.4 .Diploma (e noterizuar), të jetë i qertifikuar ne AME per mbrotje nga zjarri (noterizuar) dhe te kete trajnim për shendete dhe siguri ne pune (e noterizuara), dhe Cv e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara, ose para kontrat ne emer te projektit të noterizuara (OE dhe nga inxhinineri).** **2.5 .Diploma (e noterizuar) dhe CV e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara, ose para kontrat ne emer te projektit të noterizuara (OE dhe nga inxhinineri).** **2.6 .Diploma (e noterizuar) dhe CV e nenshkruar nga vet inxhinieri. Kontrata pune valide të noterizuara, ose para kontrat ne emer te**	

			projektit të noterizuara (OE dhe nga inxhinineri). Vendimi per udheheqes te punishtes. Te gjitha diplomat universitare jashte shtetit te Kosoves, duhet te nostrifikohen.	
		Kërkesa 3 Stafi teknik - Një (1) puntore i çertifikuar per hidroizolime; - Një (1) murator; - Një (1) teknik I elektros i çertfikuar programin e efiçiences te energjise - Një (1) saldues i çertifikuar EN 9606 – 1; - Një (1) suvatues; - Një (1) shtrues pllakash; - Një (1) hidroinstalues	Dëshmia 3 Të dëshmohen me çertifikata (të noterizuara). I gjithe stafi të ketë çertifikata për mbrojtje dhe siguri në punë (te noterizuara) si dhe me kontrata pune aktive të noterizuar ose marrveshje për bashkpunim e noterizuar. Sepaku tre prej tyre te jene te çertifikuar per mbrojtje nga zjarri (e noterizuar). Të prezentohet edhe licenca (e noterizuar) e kompanisë nga MPMS që ka kryer këto trajnime për siguri dhe shendet ne pune si dhe mbrojtje nga zjarri.	
		Kerkesa 4 Një (1) punetore i kualifikuar per sisteme me pllaka gipsi dhe ngjyrosje me 3 vitë përvojë pune	Deshmia 4 Diploma të noterizuar ose çertifikata të noterizuar, nga një qendër e aftësimit profesional ose trajnime si dhe me kontrata pune aktive të noterizuar ose marrveshje për bashkpunim e noterizuar	
		Kërkesa 5 Një (1) teknik i makinerisë me minimum 3 vite përvojë pune	Dëshmia 5 Diploma, Kontrata e punës e noterizuar ose	

			marreveshje bashkpunimi për projekt e noterizuar, CV e nënshkruar nga vet personi.	
		Kërkesa 6 Operatori duhet të deshmoj se sistemi menaxhues i ofertuesit permbush kriteret e percaktuara ne fushen e ndertimtaris se pako per keto ISO standard **-ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë** **-ISO 14001 2015 – Sistemi i Menaxhimin Mjedisor** **- ISO 3834 – 2 2006 -ISO** **45001 2015 - Certifikata për menaxhimin e shëndetit në punë EN**	**Dëshmia 6** **Operatori Ekonomik duhet të jetë i paijisur me Certifikatat ISO valide (kopje)** **Vrejtje** **Kopja e Certifikates Iso apo ciles do Certifikate me te avancuar se kjo.**	
		Kërkesa 7 **Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve** **1). Kamion– min 1 copë,** **2). Kamionet - min 2 copë,** **3). Eskavator (Skip) – min. 1 cope** **4). Pick up –Minimum 1 copë** **5). Autokorpe –minimum 2 cope** **6). paisje për grryerjen e gletit**	**Dëshmia 7** **Lista e pajisjeve dhe mekanizimit te OE ,te vulosura dhe te nenshkruara te deshmuar me libreza,per paisjet qe nuk regjistrohen te deshmohen me dud doganor të noterizuar ose fature. Për autokorpa OE duhet te ofroje raportet teknike te inspektimit (e noterizuara) nga nje kompani e licencuar per inspektim (te prezentohet licenca per inspektimit). Paisjet duhet të jenë në emër të kompanisë ose marrëveshje për marrje me qira e noterizuar.**	
		Kërkesa 8 O.E.	**Dëshmia**	

		duhet te dëshmoj se ka kryer Vlerësimin e Rriskut për puntorë dhe Stafin nga një Kompani e Licencuar nga MPMS. Raporti duhet të jetë i noterizuar -lideri	**8. Vlersimi i rriskut per kompani te deshmohet me vertetim nga nje kompani e licencuar nga organi kompetent (MPMS) se ka kryer vlersimin e rriskut per te gjitha pozitat konform ligjit 04 L-161 (vertetimi duhet te jete i noterizuar)- lideri. Licenca e noterizuar e kompanise qe ka realizur kete vlersim.**	
		Kërkesa 9 **Operatori ekonomik duhet te paraqet një plan dinamik me një përshkrim të detajuar të gjitha aktiviteteve për zbatimin e kësaj kontrate, ne baze te afatit te O.E**	**Dëshmia 9** **Planin dinamik me një përshkrim të detajuar të gjitha aktiviteteve për zbatimin e kësaj kontrate, ne baze te afatit te O.E**	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

VENDIM

Refuzohet – kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik HARST Group SH.P.K. të datë 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i palestres në Zahaq RITENDER Nr. të Prok: 635-23-3456-5-1-1dhe nr i brendeshen 635-23-032-511 nxjerr:
kundër B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK, të datës 02.06.2023 te publikuar ne platëformen elektronike të E- Prokurimit .
Vërtetohet vendimi i A.K mbi B58 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 02.06.2023

Arsyetim

Operatori Ekonomik HARST Group SH.P.K. me daten 07.06.2023, ka parashtruar kërkesen për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Ndërtimi i palestres në Zahaq RITENDER me Nr. të Prok: 635-23-3456-5-1-1dhe nr i brendeshen 635-23-032-511 nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën 08.06.2023 ka shqyrtuar kërkesen në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizes se kerkeses se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesen tuaj në platformen elektronike të datës: 07.06.2023,e ka trajtuar me kujdes kërkesen tuaj, dhe ka ardhur ne perfundim se njejta eshte e pa bazuar.

[redacted]

Gjate analizave te bere, nga A.K lidhur me pretendimet ankimore nga ana juaj Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejes ka mar vendim se te gjitha pretendimet e juaja ankimore jan te pa bazuara dhe jan ne kundershtim me LPP-ne dhe RRegullat ne fuqi, dhe ne si Autoritet Kontraktuar kemi vepruar konform LPP-se.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **HARST Group SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi I parë ankimorë ka të bëjë me arsyen e liminimit të OE ankues, ku sipas AK-së ky OE ka ofruar planin dinamik 150 ditë pune ndërsa është dashtur të ofrohet 150 ditë kalendarike.

OE ankues pretendnon se një arsyetim I tillë nuk qëndron, dhe se të njëjtit nga data e fillimit deri në përfundim kanë prashikuar planin dinamik prej 150 ditëve.

Pas analizitmit të pretendimeve ankimore, arsyetimit të AK-së dhe ofertës së OE aniues, kemi gjetur se I njëjti në planin dinamik në total ka 150 ditë.

Provë : Plani dinamik në ofertë të OE ankues.

I njëjti plan dinamik sipas tabelës së plotësuar nga OE pavarsisht shprehjes së përdorur nga OE para fillimit të tabelës "150 ditë pune", I njëjti plan nuk parasheh ditë shtesë apo ditë "jo pune".

Për më tepër, me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve, ne kemi analizuar edhe ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, e cila sipas vlerësimit tonë është plotësuar në mëyrë të njëjt, dmth duke mos parashikuar ditë "jo pune" dhe në toal ka 150 ditë, njëjt si OE ankues.

Përveq kësaj në këkesa decidive në dosje të tenderit ka qenë sin ë vijim :

"Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës:**minimim 150 dit deri ne max 250 dit kalendarike".**

Përveq kësaj kijo dëshmohet edhe përmes deklaratës së aneksi 7 deklarata e OE për afatin e implementimit të projektit dhe periudhën garantuese, ku decidivsht shënon afati i implementimit të këtij projekti është 150 ditë nga data e fillimit të punëve dhe 6 vite (maksimumi i mundshëm) periudha garantuese.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është bazuar dhe se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit.

Pretendimi nr.2

Pretendimi I dytë ankimorë ka të bëjë me arsyen tjetër të eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së OE ka ofruar certifikatë ISO 3834-2005 ndërsa është dashtë të ofrohet ISO 3834-2006, ku po ashtu sipas AK-së këtë kërkesë duhet ta plotësojnë të gjithë anëtarët e grupit veq e veq.

Fillimisht sqarojmë se ISO 3834-2006 është standard për "Saldim me shkrirje i metaleve" dhe si e tillë vlerësojmë se është kërkesë e kapacitetit Teknik/profesional e cila edhe në dosje të tenderit është vendosur tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, dhe si e tillë kjo kërkesë duhet aplikuar ndaj grupit si tërësi dhe jo të plotësohet nga secili anëtar veç e veç siç pretendon AK.

Në rastin konkret lideri grupit ka ofruar certifikatën ISO 3834-2005 (identike me ISO 3834-2006), ndërsa dy anëtarët e tjerë kanë ofruar certifikatën për saldim sipas ISO 3834-2006 ashtu si është kërkuar nga AK. Në rastin konkret ka mjaftuar që vetëm një anëtar I grupit të ofroj certifikatën në fjalë që të plotësohet kërkesa e AK-së.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është I bazuar dhe se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e nenit 71 par.4 lidhur me nenin 69 të LPP-së.

Pretendimi nr.3

Arsyetimi I radhës nga AK për eliminim të OE ka qenë se OE nuk plotëson kërkesën për :

"Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës (drejtimi energjetike) me minimum 5 vite

përvojë pas diplomimit. I certifikuar për efiçience te energjisë.".

Pas analizimit të ofertës së OE ankues kemi gjetur se për këtë kërkesë përveç personave te kontestuar nga AK , OE ka ofruar dëshmi për z. Shabani i cili plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu edhe z.Nitaj ka ofruar dëshmitë në pajtim me kërkesat e dosjes Dmth. Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës dhe certifikatën për efiqencë.

AK po ashtu ka mund që në pajtim me nenin 72 të kërkoj sqarime shtesë për personat e kontestuar që janë marr si arsye për eliminim.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se OE plotëson kërkesat e dosjes së tenderit për Inxhinier i Diplomuar elektroteknik i certifikuar për efiqencë.

Pretendimi nr.4

Arsyetimi i radhës për eliminimit të OE ankues është se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi për Eskavator (skip), ku sipas AK-së :

"*keni paraqitur një dëshmi, marrëveshje, me OE"LG Construction Group SH.P.K", për paisjen Ngarkues me lugë, Marka: Fermec. Mirëpo kjo pajisje nuk është në listën e asnjërit nga OE*.".

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues është se pavarësisht faktik nëse OE nuk e ka shënuar në "listë" të pajisjeve pajisjen në fjalë, ofrimi i dëshmive/marrveshjes është provë bindëse dhe e pamohueshme se OE ka në dispozicion këtë pajisje.

Po ashtu OE ka ofrua dëshmi edhe për eskavator të tjerë që sipas mendimit tonë plotësojnë kërkesën e AK-së, kjo sepse termi "skip" nuk e definon asnjë pajisje as në gjuhë shqipe apo gjuhë të tjera. Për më tepër nëse hulumtohet në internet termi se 'skip" jep rezultate për kontejner të mbeturinave qka nuk ka të bëjë as me esakavator e as me ngarkues.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi nr.5

Pretendimi tjetër ankimorë është se OE ankues duhet të jetë i renditur i pari sipas pikëve.

Pas kalkulimeve tona në pajtim kushtet/tabelën e vendosur nga AK, ku çmimi merr 50%, afati iplimentimit 20% dhe periduha garantuese 30%, OE ankues do duhej të renditet i pari me 99.9%, ndërsa OE fitues "Termomontimi" i dyti me 95.00%.

Kjo për arsye se cmiimi i cili mban 50% të pikëve, dallimi mes OE të rekomanduar dhe OE ankues rreth 0.1%, ndërsa periudha garantuese e cila bart 30% të poenave dallimi mes OE të rekomanduar me 5 vite garancion dhe OE ankues me 6 vite garancion është 20% diferencë, gjegjësisht OE ankues merr 30% të pikëve ndërsa OE i rekomanduar 25% të pikëve.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi nr.6

Pretendimet 6, 7 dhe 8 kanë të bëjnë me kërkersën e AK-së ku është kërkuuar që kontratat të jenë të noterizuara.

OE ankues pretendon se ofrimi i "kopjes së noterizuar" nuk plotëson kërkesën e AK-së për "kontartë të noterizuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues është se kërkesa e dosjes ka qenë që "kontrata e noterizuar" e jo kopja e noterizuar.

Dallimi esencial sipas mendimit tonë në mes këtyre dy dokumenteve është se npterizimi i kontratës kërkon vërtetimin e nënshkrimit të gjitha palëve në prani të noterit, me qka edhe formalizohet/solemnizohet dokumenti/kontrata, ndërsa vërtetimi i kopjes së një kontrate nuk kërkon

vërtetimin e asnjë nënëshkrimi të asnjë pale dhe nuk e formalizon.solemdnizon dokumentin në fjalë.

Megjithatë vlerësohjmë se me rastin eventual të rivlerësimit AK mund të kërkoj informata/sqarime shtesë, nëse këta persona janë vërtetë punëtor të kompanisë përmes dëshmive nga ATK, kontributeve të rregulltra mujore dhe vjetore.

Pretendimi nr.7

Pretendimi i fundit ankimorë është se OE për z Hajdari, certifikatën e efiqencës nga SEEK ku trajnues ka qenë GFS Consulting nuk e plotëson kërkesën e AK-së për certifikim në efiqencë.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, kemi gjetur se certifikatat për efiqencë të energjisë në Kosovë lëshohen nga Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri pran Universiteti Hasan Prishtina së bashku me Ministrinë e Ekonomisë – Agjencia e Kosovës për Efiqencë të Energjisë dhe trajnimi zgjat për mbi 1 muaj, dhe përfshinë leksionet, auditimin në terren, përgaditjen e raportit të auditimit të energjisë dhe provimin bazuar standardin DIN EN 16247 pwr efiqencw tw energjisw.

Ndërsa OE i rekomanduar ka ofruar certifikatë të një kursi dy ditorë të lëshuar nga SEEK dhe kursi është mbajtur nga GFA Consulting Grup.

Mendimi ekspertit është se certifikata e kursit dy ditor e mbajtur nga GFA consultin Group dhe e lëshuar nga SEEK nuk plotëson kërkesën Certifikim në Efiqencë të energjisë pasi një certifikim i tillë bëhet nga institucionet vendore përkatëse të për shkruara më lart.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **HARST Group SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Ilir Halili